



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Nr 573 Prot

Lezhë, me 31.03.2022

VENDIM

Nr 84 datë 31.03.2022

**“ PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 72, DATË 21.03.2022,
PËR SHPALLJEN E PROCEDURAVE TË KONKURIMIT
“PËR DREJTUES TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PUBLIK”**

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 44, datë 30.04.2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Nenet 124, pika 1, 125, VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimit Nr 30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, Urdhër i ZVAP Shkodër nr.58, datë 28.03.2022 , “ Për kthimin e shkollës 9-vjeçare “ Ernest Koliqi”, në ankes të Shkollës 9-vjeçare “ Ruzhdi Daca” Bashkia Shkodër,

KONSTATOVA:

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar më datë 21.03.2022, shpalli procedurat e konkurrimit për institucionet arsimore në juridiksion të ZVAP-ve në varësi të saj.

Në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë, më datë 31.03.2022, është dërguar Urdhër i ZVAP Shkodër, nr. 58, datë 28.03.2022, “Për kthimin e shkollës 9-vjeçare “ Ernest Koliqi”, në aneks të Shkollës 9-vjeçare “ Ruzhdi Daca” Bashkia Shkodër, për shkak të numrit të nxënësve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 124, pika 1, 125 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S A:

1. Ndryshimin e Urdhër. Nr. 72, datë 21.03.2022, “Për shpalljen e procedurave të konkurrimit për drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar”, konkretisht në shpalljet e institucioneve arsimore për ZVAP Shkodër, **Shkolla 9- vjeçare “ Ernest Koliqi” nuk është institucion arsimor që i nënshtrohet procedurave të konkurrimit për shkak të kalimit në shkollë vartëse.**
2. Lënien në fuqi të Urdhrit nr. 72, datë 21.03.2022, “Për shpalljen e procedurave të konkurrimit për drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar”, për shpalljet e tjera.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

